



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2023:146279

Datë: 10.10.2024

Numri i dokumentit: 06283002

**C.nr.2344/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil**, me gjyqtarin Gëzim Shehu, në çështjen juridike kontestimore të paditëseve A. M. nga Prizreni dhe D.S. nga Prizreni, të cilat me autorizim i përfaqëson av. A.H. nga Prizreni, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. - Spitali Regjional i Prizrenit, për çështjen juridike me objekt kontesti padi për kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,155.00 (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) euro, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 10.10.2024, mori këtë:

## **A K T G J Y K I M**

**I. REFUZOHET** kërkesëpadija e paditëseve A.M. dhe D.S. nga Prizreni, me të cilën kanë kërkuar që të *“DETYROHET e paditura Sh.S.K.U.K.-Spitali Regjional në Prizren, që paditëseve në emër të përmbushjes së Kontratës Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë nr.05-3815 e datës 12.06.2018 neni 17 par.3, t’ia paguajë shumat e lartcekura A.M. shumën prej 577.50 dhe paditëses D.S. shumën prej 577.50 euro, me kamat vonesë 8% nga data e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e marrjes së këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm”*, **si e pa bazuar.**

**II.** Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

## **A r s y e t i m**

Paditëset A.M. dhe D.S. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tyre av. A.H. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate me datë 04 korrik 2023, kanë parashtruar padi kundër të paditurës Sh.S.K.U.K.-Spitali Regjional Prizrenit, për çështjen juridike me objekt kontesti padi për kompensimin e pagave jubilarë, vlera e kontestit 1,155.00 (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e pesë) euro.

Në referatin e padisë i autorizuari i paditëseve ka theksuar se paditëset instrumentare

janë të punësuar në Spitalin Regjional të Prizrenit në bazë të kontratave të punës dhe atë në kohëzgjatje të pacaktuar. Paditëset në mbështetje të nenit 22.43.44 dhe nenit 145 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 4 para. 1 të Konventës Ndërkombëtare C98 të Organizatës Ndërkombëtare të Punës, nenit 90 par.1 nënpar.1.1 dhe 1.2 dhe par.2 me nën par.1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, Ligjit për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë Nr.04/L-161 dhe nenit 17 par.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale e vitit 2018 të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, kërkojnë nga e paditura kompensimin e pagës jubilarë për 10 vjetëshin e dytë në shumën e një page bazë të të punësuarve në mjekësi në Spitalin Regjional të Prizrenit. Paditëset A.M. dhe D.S. në bazë të provave të dorëzuara si instrumentare realizojnë pagën bazë prej 577.50 euro, meqenëse e paditura nuk e ka përmbushur detyrimin sipas Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë ka kërkuar që të aprovohet kërkesëpadia e paditëseve. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar të cilat i ka specifikuar dhe atë për përpilimin e padisë 156 euro si dhe për taksën gjyqësore 31 euro.

E paditura në përgjigje në padi i ka kundërshtuar në tërësi të gjitha pretendimet e palës paditëse në padi. Ka theksuar se paditësja A.M. ka filluar marrëdhënien e punës në SPZ më 10.08.2002, ku edhe vazhdon të punojë, paditësja D.S. ka filluar marrëdhënien e punës në SPZ më 01.10.2002 ku pas refuzimit të kërkesave për pagesë në emër të një (1) page jubilarë, i janë drejtuar gjykatës për realizimin e kërkesës së tyre. Kërkesëpadia e paditëses është e pa bazuar nga arsyet se paditëset kërkesën e bazojnë në Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive në neni 52 dhe 53, e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje nga marrëdhënia e punës. Më tej ka theksuar se me dispozitat nga par.3 të këtij neni të Kontratës Kolektive është paraparë që shpërblimi jubilar paguhet në afat prej një muaji, pas plotësimit të kushteve nga ky paragraf, kjo do të thotë se shpërblimet jubilarë paguhet në afat prej një muaji prej ditës kur i punësuar mbush 10, 20 dhe 30 vite përvojë pune të pandërprerë me rastin e jubileut të ashtuquajtur vit jubilar. Gjithashtu ka theksuar se paditësja A.M. marrëdhënien e punës e ka themeluar më 10.08.2002, ku mund të konstatojnë se paditësja tek i paditura 20 vjet përvojë pune i ka mbushur më 10.08.2022, vit ky për të cilën ka qenë jubilar, në të cilën vit Kontrata Kolektive Sektoriale nuk ka qenë në fuqi, ku gjithashtu MPKK nuk përmban dispozitave të efekteve retroaktive, para se të hyp në fuqi i njëjti. Ndërsa paditësja D.S. marrëdhënien e punës e ka themeluar më 01.10.2002, ku mund të konstatojnë se paditësja tek i paditura 20 vjet përvojë pune i ka mbushur më 01.10.2022, vit ky për të cilën ka qenë jubilar, në të cilën vit Kontrata Kolektive Sektoriale nuk ka qenë në fuqi, ku gjithashtu MPKK nuk përmban dispozitave të efekteve retroaktive, para se të hyp në fuqi i njëjti, andaj sipas kësaj paditëseve nuk i takon e drejta në pagesën e shpërblimit jubilar dhe për këtë arsye ka kërkuar nga gjykata që ta refuzojë kërkesëpadinë e paditëseve si të pa bazuar. Në fund ka theksuar se kërkesëpadia

është bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor për të vepruar me datën 12.06.2021. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga e paditura, ka gjetur se janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës, të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, kjo sepse nga faktet e treguara në padi, dhe prapësimet e ngritura nga e paditura në përgjigjen në padi rezulton qartazi se kërkesëpadia e paditëseve është e **pa bazuar**.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditëset janë në marrëdhënie pune tek e paditura, në Spitalin Rajonal në Prizren. Kontestuese në mes palëve ndërgjyqëse është nëse paditëseve i takojnë e drejta për kompensimin e pagave jubilarë për 20 vite përvojë pune.

Nga vërtetimi me nr.amz. 717, të datës 21.06.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A.M. është në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren nga data 10.08.2002, ku ende vazhdon të punoj dhe ka gjithsej 20 vite, 10 muaj dhe 9 ditë përvojë pune në këtë spital, kurse paga e fundit bazë është 577.50 euro.

Nga kontrata e punës me numër 717 me titull të postit H-47, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A.M. ka të themeluar marrëdhënien e punës me punëdhënësin Spitalin Rajonal "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës infermiere.

Në bazë të listës së pagave, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja A.M. realizon pagën bazë në shumën prej 577.50 euro.

Nga vërtetimi me nr.amz. 1011, të datës 21.06.2023, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja D.S. është në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren nga data 01.10.2002 ku ende vazhdon të punoj dhe ka gjithsej 20 vite, 8 muaj dhe 18 ditë përvojë pune në këtë spital, kurse paga e fundit bazë është 577.50 euro.

Nga kontrata e punës me numër 1011 me titull të postit H-59, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja D.S. ka të themeluar marrëdhënien e punës me punëdhënësin Spitalin Rajonal "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren në vendin e punës instrumentare.

Në bazë të listës së pagave, gjykata ka vërtetuar faktin se paditësja D.S. realizon pagën bazë në shumën prej 577.50 euro.

Me nenin 4 par.2 të Ligjit të Punës 03/L-212, i cili është në fuqi parashihet se:  
*"Kontrata Kolektive nuk mund të përmbajë të drejta më pak të favorshme për të punësuarin*

*dhe punëdhënësin se sa të drejtat e përcaktuara me këtë ligj". Po ashtu me nenin 90 të këtij ligji parashihet se "1. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet ndërmjet: 1.1. organizatës së punëdhënëseve ose përfaqësuesit të tij, dhe 1.2. organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve; 2. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në: 2.1. nivel të vendit, 2.2. nivel të degës, 2.3. nivel të ndërmarrjes; 3. Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhët zyrtare të Republikës së Kosovës; 4. Marrëveshja Kolektive mund të lidhet për një periudhë të caktuar me kohëzgjatje jo më shumë se tri (3) vjet; 5. Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive; 6. Marrëveshja Kolektive nuk mund të përfshijë dispozita të tilla që kufizojnë të drejtat e të punësuarve që kanë si pasojë kushte më pak të favorshme të punës sesa ato të përcaktuar në këtë ligj".*

Nga provat e administruara dhe të cekura më lartë, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditëseve duhet të refuzohet si e pa bazuar lidhur me kompensimin e pagave jubilarë për 20 vite të përvojës në punë dhe atë shumën nga 577.50 euro për secilën prej paditëseve apo shumën e përgjithshme prej 1,155 euro dhe atë duke u bazuar në vetë kërkesën e palëve paditëse, pasi që të njëjtat kanë kërkuar që të bëhet kompensimi i pagave jubilarë, në kuptim të nenit 17 para. 3.2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë të datës 11.06.2018. Duke analizuar nenin në fjalë, shihet se kërkesa e palëve paditëse është për shpërblimin jubilar për 10 vjetëshin e dytë të përvojës së punës. Nga vërtetimi mbi përvojën e punës të lëshuar nga e paditura me datë 21.06.2023, vërtetohet fakti se paditësja A.M. është në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren nga data 10.08.2002, ku ende vazhdon të punoj dhe ka përvojë pune prej 20 vite, 10 muaj dhe 9 ditë, e cila është llogaritur deri me datën 20.06.2023. Paditësja vitin jubilar 20 vjet të përvojës së punës e ka arritur me datën 10.08.2022, ndërsa paditësja D.S. është në marrëdhënie pune në Spitalin e Përgjithshëm "Prim.Dr.Daut Mustafa" në Prizren nga data 01.10.2002 ku ende vazhdon të punoj dhe ka përvojë pune prej 20 vite, 8 muaj dhe 18 ditë, e cila është llogaritur deri me datën 20.06.2023. Paditësja vitin jubilar 20 vjet të përvojës së punës e ka arritur me datën 01.10.2022. Andaj gjykata duke marrë për bazë Mendimin Juridik për shpërblimin jubilar, të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës të datës 27.02.2023 pika V, erdhi në përfundim se paditëset kërkesën e tyre për kompensimin e pagave jubilarë e kanë mbështetur në Kontratën Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë në Kosovë të datës 11.06.2018, e cila kontratë në momentin e arritjes 20 viteve të përvojës së punës nga ana e paditëseve nuk ka qenë në fuqi, ngase e njëjta ka qenë në zbatueshmëri nga data 11.06.2018 deri më 10.06.2021. Mbi këtë bazë gjykata konstaton se Kontrata Kolektive Sektoriale e Shëndetësisë e datës 11.06.2018 nuk ka zbatueshmëri në këtë çështje juridiko kontestimore pasi që paditëset 20 vite përvojë pune tek e paditura i kanë arritur jashtë periudhës së zbatimit të kësaj kontrate, gjegjësisht paditësja A.M. me datë 10.08.2022 ndërsa paditësja D.S. me datë 01.10.2022, dhe për këtë arsye kërkesëpadia e paditëseve

refuzohet si e pathemeltë.

Lidhur me shpenzimet e procedurës gjykata vendosi si në dispozitivin nën **II** të këtij aktgjykimi, ashtu që secila palë t'i bartë shpenzimet e procedurës, konform nenit 450 të LPK-së, pasi që pala e paditur nuk i ka kërkuar ato.

Nga të cekurat më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 143 dhe 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.2344/2023, me datë 10.10.2024**

**G j y q t a r i**

---

**Gëzim Shehu**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.